



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 92/1 Prot.

Tiranë, më 17.01.2023

**V E N D I M**

**Nr. 04 , Datë 17 . 01 . 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> shqyrtoi ankesën nr. 165, datë 28.10.2022, të R.A kundër Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a (FSHU), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës<sup>3</sup>” dhe “çdo shkak tjetër<sup>4</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam R.A banues në qytetin e Shkodrës dhe kam në pronësi dy shtëpi, si rrjedhojë kam të lidhura dy kontrata me FSHU-në. Në njërin shtëpi banoj unë, kurse në shtëpinë tjetër nuk banon njeri. Në muajin Shtator 2022 unë faturohem njësoj për të dy banesat në vlerën 2733.40 lekë<sup>5</sup>. Ndërkohë që në faturën e muajit Gusht 2022, jam faturuar në vlerën 385.00 lekë<sup>6</sup>. Kam bërë ankesë<sup>7</sup> pranë OSHEE por nuk kam marrë akoma asnjë përgjigje. Unë jam pensionist dhe nuk mund të paguaj për diçka që nuk e kam konsumuar. Pra diskriminohem sepse kam dy shtëpi (çdo shkak tjetër) dhe për të dy shtëpitë paguaj njësoj dhe pse vetëm njëra shtëpi është e banueshme nga unë. Nuk ndodh me askënd tjetër që në një banesë ku nuk ka konsum energjie

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Ankuesi ka lindur në datë 17.04.1939 dhe është pensionist.

<sup>4</sup> Ankuesi është pronar i dy shtëpive dhe ka të lidhura dy kontrata furnizimi me energji elektrike.

<sup>5</sup> Kodi i klientit: SH2A020006143998; Nr. Kontrate: A 143998; Numri i Faturës: 440048097.

<sup>6</sup> Kodi i klientit: SH2A020006143998; Nr. Kontrate: A 143998; Numri i Faturës: 438927388.

<sup>7</sup> Nr. Çështje: CSC2201022045, datë 20.10.2022, ora 08.09.

*të paguaj atë vlerë që më kanë vendosur mua, përveç vlerës së zakonshme që paguhet për kontratën”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e faturimit të paligjshëm nga ana e FSHU.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 165, datë 28.10.2022, të bërë nga R.A, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1411/1, datë 01.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga FSHU sh.a, për ankesën e bërë nga R.A, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Informacion në lidhje me situatën e faturimit të energjisë elektrike të ankuesit.
  - Kopje të procedurës së shqyrtimit të ankesës dhe të përgjigjes së dhënë ankuesit.
  - Informacion mbi historikun e faturimit të energjisë elektrike gjatë 12 muajve të fundit për Kontratën nr: A 143998, të klientit: SH2A020006143998.
- Në mungesë të përgjigjes së FSHU sh.a, nëpërmjet shkresës me nr. 1411/2, datë 23.11.2022, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtesë për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që brenda datës 01.12.2022 të paraqesë parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Në vijim, FSHU sh.a, pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Me shkresën nr. 1411/4, datë 22.12.2022 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar FSHU sh.a. me Vendimin nr. 227, datë 22.12.2022, në të cilin institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. është gjobitur në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga R.A.

Me shkresën nr. 9159/1, datë 29.12.2022, FSHU sh.a., ktheu përgjigje, duke informuar Komisionerin ndër të tjera se: *“Abonenti R.A ka paraqitur ankesë për kontratën me kod SH2A020006143998, regjistruar në sistemin Mpower me nr. CSC2201022045, me datë*

20.12.2022 me anë të së cilës është ankuar për faturën e muajit Shtator 2022 me faturim aforfe.

Departamenti i Marrëdhënieve me Klientin pranë FSHU sh.a mori masa për shqyrtimin dhe zgjidhjen kësaj ankese. Pas kryerjes së verifikimeve përkatëse dhe në përfundim të shqyrtimit të ankesës, janë marrë masa dhe janë ekzekutuar në sistem këto veprime:

- Zbritjen e faturës së muajit Tetor 2022 me aktiv 1 kWh dhe muajit Shtator 2022 nën zërin vlerë referuese ERE me 231 kWh.
- Anulimin e faturës së fundit me vlerë referuese balancuese.
- Vijimin e leximit sipas gjendjes reale në matës.

Ndërkohë pas depozitimit të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet së cilës është përcjellë ankesa e këtij abonenti, është regjistruar në sistemin e faturimit çështja me nr. CSC2051222489, dhe pas shqyrtimit të saj është vendosur:

- Të zbritet fatura Gusht 2022 nën emërtimin Ambient i Përbashkët në masën (25) kWh.

Aktualisht të dyja këto vendime janë ekzekutuar në sistemin e faturimit, për të cilat abonenti nëpërmjet këtij sistemi është vënë në dijeni.

Na lejoni t'ju bëjmë me dije se duke vlerësuar punën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore për mbështetjen e tij, duke i garantuar aksesin në informacion, Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk ka pasur për qëllim mos dërgimin e informacionit të kërkuar, por në kushtet kur ankesa e abonentit është pranuar dhe zgjidhur, e ka vlerësuar të ezauruar këtë ankesë”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi është kontaktuar nëpërmjet specialistes së Komisionerit pranë Zyrës Rajonale Shkodër dhe është njohur me përgjigjen e FSHU sh.a.

Pasi është njohur me qëndrimin e provat e sjella nga FSHU sh.a., ankuesi, nëpërmjet procesverbalit të mbajtur në datë 10.01.2023, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar masat e marra nga FSHU sh.a, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e ankesës së faturimit të energjisë elektrike të banesës së tij.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e

*nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

Gjithashtu, bazuar në ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, neni 33/11, “*..... Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni*”, Komisioneri arrin në përfundimin se FSHU sh.a. ka paraqitur informacionin e kërkuar brenda afatit ligjor të kërkuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9,10 dhe 11, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 165, datë 28.10.2022, të R.A, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Shfuqizimin e Vendimit me gjobë nr. 227, datë 22.12.2022.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**